

Ftesë për Tender
Referencë: ITT/IHS/2026/001

20.02.2026

Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH) është duke implementuar projektin e quajtur: “Shërbimet Shëndetësore të Integruara” (IHS), për të kontribuar në përmirësimin e shëndetit të popullatës përmes përsosmërisë në kërkime, shërbime, mësimdhënie dhe trajnime në Kosovë. Me anë të kësaj ftese, Projekti IHS fton tenderuesit legjitim dhe të kualifikuar për të kryer aktivitete që lidhen me furnizimin dhe instalimin e sistemeve të sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, për zbatimin e:

Projektit të Gatishmërisë për Siguri dhe Reagim ndaj Fatkeqësive/Sistemit të sigurisë kundër zjarrit, në Spitalin e Përgjithshëm (SP) të komunës së Pejës.

Kompanitë e interesuara për aplikim mund ta paraqesin kërkesën për marrje të dosjes së tenderit, çdo ditë pune prej orës: **8:30-16:30**, duke kontaktuar zyrën e IHS Projektit në Kosovë, përmes e-mail adresës: procurement@ihsproject.org e ku përveç kërkesës duhet të paraqesin edhe të dhënat e kompanisë si: **Emrin e kompanisë dhe Numrin unik identifikues**. Afati i fundit deri kur Operatorët Ekonomik mund ta kërkojnë dosjen e tenderit është data: **04.03.2026 ora 09:00 AM**. Pas pranimit të kërkesës, dokumentacioni do t’ju dërgohet kompanive përmes emailit. Të gjitha detajet e nevojshme për aplikim i gjeni në dosjen e tenderit.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është me 13.03.2026, në ora 11:00 AM, në këtë adresë:

Rr. Tirana, Prime Residence, hyrja. A, kati. 9, Ap. 20, 10000 Prishtinë, Kosovë. Ofertat duhet të dorëzohen në formë fizike në formatin si vijon:

- 1 Original + 1 kopje fizike e ofertës si dhe
- 1 USB apo CD- (forma elektronike e cila duhet ta përmbajë të gjithë dokumentacionin e ofertuar nga OE) dhe se bashku duhet të dorëzohen **në një zarf të vetëm të mbyllur**. Oferta duhet të dorëzohet duke përdorur një sistem me dy zarfe, si më poshtë:

- **Zarfi A**– Oferta administrative dhe teknike dhe
- **Zarfi B**– Oferta financiare

Të dy ofertat duhet të jenë të mbyllura dhe të vendosen në një zarf të vetëm të mbyllur. Oferta duhet drejtuar për IHS Projektin dhe në zarf duhet të shënohet: “Sistemi i sigurisë kundër zjarrit për SP në Pejë”, dhe numri i referencës: ITT/IHS/2026/001.

Shenim: VIZITA NË TERREN ËSHTË E OBLIGUESHME. Operatorët Ekonomik (OE) inkurajohen të vizitojnë dhe shqyrtojnë vendin e punimeve dhe rrethinën e tij për të marrë të gjitha informatat që mund të jenë të nevojshme rreth përgatitjes së ofertës.

Me rëndësi: Mospjesmarrja e Operatorit Ekonomik (OE) në viziten në terren nënkupton edhe refuzimin e ofertës të Operatorit Ekonomik. Vizitat në terren janë paraparë dy herë, me datat: **26.02.2026** dhe me **04.03.2026**. Operatori Ekonomik (OE) mund të marrë pjesë në njërin ose në të dy vizitat në terren. Për konzorciumet; mundet të marrin pjesë njëri apo të gjithë anëtarët e konzorciumit të OE.

Lokacioni dhe koha e vizites:

- Spitali i Përgjithshëm në komunën e Pejës (reparti i Emergjencës) ora **11:00 AM**,

Për informata shtesë, mund ta kontaktoni IHS Projektin në email adresën si mëposhtë:

procurement@ihsproject.org